



REPUBLIKA E SHqipërisë
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Njoftim për shtyp

Pasi jemi njohur me deklaratat në media, AZHBR informon publikun mbi pretendimet e shprehura janë të pavërteta.

Informacioni mbi të gjithë financimet e disbursuara nga Programi IPARD II është transparent dhe i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët.

Programi është akredituar nga strukturat e B.E si dhe audituar dhe certifikuar nga Agjencia e Auditimit të fondeve IPA dhe strukturat monitoruese për zbatimin e programit.

PROCESI I VLERESIMIT TE APLIKIMEVE NË AZHBR

Në momentin e shpalljes së thirrjes për aplikime, publikohet zyrtarisht Udhëzuesi për aplikantët me kriteret e përfitueshmërisë për secilën nga Masat e investimit. Pjesë e të cilit është lista e dokumentave të cilat duhet të dorëzohen në mënyrë që të miratohet projekti për financim me grant.

I. VERIFIKIMI ADMINISTRATIV

1. Statusi ligjor dhe financiar i aplikantit:

- Gjendja juridike e aplikantit/përfaqësuesit ligjor (i dënuar ose jo nën hetim ose jo), nëpërmjet vërtetimeve nga autoritetet kompetente.
- Formalizmi i ekonomisë, nëpërmjet regjistrimit në QKB (aktiv dhe me aktivitet)
- Legjitimiteti për kryerjen e shërbimeve në kuadër të investimeve (pajisja me license)
- Shlyerja e detyrimeve tatimore, taksave kundrejt shtetit.

2. Qëndrueshmëria e investimit:

- Verifikimit dhe vlerësimit të Planit të Biznesit ose Projekti Teknik (IRR dhe NPV)
- Drejtën e pronësisë/përdorimit në pronën ku kryhet investimi
- Vlerësimi i investimit nëpërmjet verifikimit të projekteve (konstruktiv, arkitektonik, teknologjik etj) në varësi të investimit.

3. **Plotësimi i standarteve**, investimi plotëson standartet minimale kombëtare dhe ato të BE në varësi të masës dhe investimit (standartet e mjedisit, sigurisë ushqimore, sigurisë në punë etj.)

II. **VERIFIKIMI NË TERREN** Verifikohen elementë e deklaruar në aplikim i korrespondojnë apo jo faktit lidhur me; pronësinë, standartet minimale dhe ato të BE-së, gjendjen e investimit dhe përputhshmërinë me projektin e aplikuar.

III. **MONITORIMI EX-POST** kryhet brenda 5- viteve nga ekzekutimi i pagesës AZHBR verifikon n.q.s. përfituesi vijon të mbaj në funksion investimin sipas kushteve të kontratës.